



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e qirasë mesatare mujore të banesave”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin.

“Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit si ministria përgjegjëse për strehimin ,për zbatimin e politikave të strehimit për familjet e pastreha, kanë planifikuar fonde për financimin e bonusit të strehimit për vitin 2026, për qytetarët në nevojë për t’u strehuar , nisur dhe nga fakti që ka shumë familje të pastreha që kërkojnë dhe plotësojnë kriteret për përfitimin e bonusit të strehimit ,pasi ne nuk kemi banesa sociale të lira për tu ndarë .Ky projekt po zbatohet nga bashkia që prej vitit 2017 dhe nga viti në vit numri i familjeve qe trajtohen me bonus qiraje është në rritje .

Situata financiare : Për fillimin e procedurës është e nevojshme miratimi i qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2025 ,sipas strukturës së apartamentit, pasi nuk ka akte ligjore apo nënligjore që të përcaktojnë nivelin e qirasë sipas Bashkive .Për sa më sipër propozohet miratimi i çmimit mesatar të qirasë në tregun e lire ,të marra gjatë një viti ,sipas strukturës së apartamentit dhe vendodhjes së tij vetëm për struktura 1+1 dhe 2+1,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1.Për Lagjen Nr.1dhe Nr.3

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15 000 lekë.

- Për apartamentinme strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 20 000 lekë.

2.Për Lagjen Nr.2

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 17 000 lekë.

-Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 22 000 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Mbrojtjes Civile Sherbimeve, Transportit dhe Pronave .

Impakti social / grupet që preken:

Kërkesat e shumta për bonus strehimi shoqërohen me vështirësi, për gjetjen e banesave në tregun e lire edhe pse ka shumë banesa bosh ,pronarët e tyre hezitojne ti japin me qira , pasi nuk kanë besim te qiramarrësit se ata do të jenë korekt në pagesat e konsumimit të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe hezitojnë nga pagesa e tatimit në vlerën 15% të çmimit të kontratës së qirasë/ mujore edhe pse me ndryshimet qe ju bënë ligjit 22/2018 “Për strehimit social “ me ligjin nr.48/2023, ata përjashtohen nga pagesa e kësaj vlere, pasi kjo vlerë do të subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 30 /01/2026,ora 09:00, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e qirasë mesatare mujore të banesave në tregun e lire”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Miratimn e nivelit të qirase mesatare mujore të banesave në tregun e lirë sipas strukturës së apartamentit , si më poshtë:

1.Për Lagjen Nr.1dhe Nr.3

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15 000 lekë.

-Për apartamentinme strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 20 000 lekë.

2.Për Lagjen Nr.2

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 17 000 lekë.

- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 22 000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Për strukturën garsoniere për shkak të mungesës së të dhënave në tregun e lirë ,si vlere të qirasë mesatare të meret vlere e kontratës së qirasë lidhur para noterit e dorëzuar nga aplikuesi për bonus qiraje .

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 30 /01/2026